POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1  Të shtriré e të mbuluar në gjak si viktimat e Buchës, një grup njerëzish në Pragë kujtojnë jetët e humbura në Ukrainë

2  61-vjeçari në Roskovec vrau bashkëjetuesen e djalit e më pas u vetëvar, flet e motra: Thoshte do t'i ther të dy! Nusja rrinte mbyllur në dhomë, kishte frikë

3  61-vjeçari vrau bashkëjetuesen e djalit, gruaja duke larë gjakun e të resë: E acaronte, i thoshte dil nga shtëpia se është e imja

4  Putin: E pamundur të izolohet Rusia, të gatshëm të bashkëpunojmë me partnerë që dëshirojnë

5  Rama: Nëse s'marrim drité jeshile në qershor nga BE për shkak të Bullgarisë, do kërkojmë të ndahemi nga Maqedonia! Scholz: Integrimi të ndodh sa më shpejtë

Kronikë

Tiranë/ Tentoi të vriste me armë zjarri të riun pas një sherri, arrestohet 28-vjeçari! I gjendet dhe pistoleta me të cilën do kryente krimin (VIDEO)

Emra Korteshi pas një sherri me një 35-vjeçar ka marrë armën e zjarrit me qëllim që ta vrasë, por për fat të mirë kjo rezultoi një tentativë e dështuar. Bëhet fjalë për ngjarjen e ndodhur një ditë më parë në rrugën "Shaban Bardhoshi".



Redaksia
12 Prill, 18:06 | Përditesimi i fundit: 12 Prill, 18:46

TIRANË- Emra Korteshi pas një sherri me një 35-vjeçar ka marrë armën e zjarrit me qëllim që ta vrasë, por për fat të mirë kjo rezultoi një tentativë e dështuar. Bëhet fjalë për ngjarjen e ndodhur një ditë më parë në rrugën "Shaban Bardhoshi".

Nga sa mësohet dyshja është konfliktuar me njëri-tjetrin për motive që nuk dihen ende dhe Korteshi ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të E. I., 35 vjeç dhe më pas është larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes. Megjithatë, arratia i ka zgjatur disa orë.



LEXO EDHE:
Doli të blinte bukë, por gruaja sulmohet nga qentë 'pit bull' në Tiranë: Më shpëtuan fqinjët

Ai është vënë në prangat e policisë dhe ndaj tij rëndojnë akuzat për veprat penale "Vrasja me dashje" mbetur në tentativë, dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit". Ndërkohë, siç bëjnë me dije burime zyrtare nga uniformat blu, atij i është sekuestruar edhe pistoleta me të cilën 28-vjeçari tentoi të kryente vrasjen.

> *"Finalizohet operacioni policor i koduar "Speed", i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Nr. 6. Tentoi të vriste me armë zjarri një shtetas, vihet në pranga një 28-vjeçar. Sekuestrohet arma e zjarrit pistoletë, me të cilën 28-vjeçari tentoi të kryente vrasjen. Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6, pas marrjes së njoftimit se gjatë një konflikti për motive të dobëta, në rrugën "Shaban Bardhoshi", një shtetas ka qëlluar me armë zjarri drejt një shtetasi tjetër, dhe më pas është larguar, kanë organizuar punën me qëllim kapjen e autorit të dyshuar dhe kanë finalizuar me sukses operacionin policor të koduar "Speed".*
>
> *Si rezultat i punës dhe veprimeve të shpejta profesionale, nga specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Nr. 6, brenda pak orësh, u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit: - E. K., 28 vjeç, banues në Kombinat, për veprat penale "Vrasja me dashje" mbetur në tentativë, dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".*
>
> *Shtetasi E. K., ditën e djeshme, gjatë një konflikti për motive të dobëta, në Kombinat, në rrugën "Shaban Bardhoshi", ka tentuar të vrasë me armë zjarri, shtetasin E. I., 35 vjeç, dhe më pas është larguar. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua arma e zjarrit pistoletë. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme", thuhet në njoftimin e policisë.*

B.K./Sh.Sh/Shqiptarja.com

TAG: sherr | tentative vrasje | policia e tiranes | Emra Korteshi | Tirane

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A mendoni se SHBA-të do vijojnë të ndëshkojnë politikanët e korruptuar?

Po | Jo | Nuk e di


Lajme të tjera

Kronikë



Tiranë/ Pasi u zunë fizikisht, qëlloi me armë zjarri drejtim të riut, në kërkim një 28-vjeçar
12 Prill, 13:06

Politikë



Firmoset marrëveshja, Gjermania njeh patentat shqiptare, hyn në fuqi më 1 qershor! Sekretari gjerman: Hap i vogël drejt BE! Ministrja e Infrastrukturës: Finalizim i një procesi të gjatë
12 Prill, 12:59

Kronikë



IKMT aksion në Golem për shembjen e kabinave të vjetra të pushimit, jetonin 12 familje, Bashkia e Kavajës: Janë të dëmtuara nga tërmeti, po i prishim për çështje sigurie
12 Prill, 11:29

Kronikë



Ngrihet Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile në Tiranë, presidenti i Dhomës Italiane, Fico: Ky investim do shpëtojë jo vetëm jetë, por do parandalojë dhe katastrofa
12 Prill, 09:53

Sociale



'Shpëtoni një jetë', motra dhe babai marshim për 14 vjeçarin e sëmurë nga Kashari në Divjakë! Mateos së vogël i duhen 26 mijë euro për të jetuar


 Enxhi Musaj
11 Prill, 22:30

Kronikë



Videolajm/ Pacienti i plagosur i 'ikën nga duart' mjekëve sapo ambulanca u nis për ta dërguar në Tiranë, policët vrap pas tij për ta kapur
11 Prill, 20:57

Kronikë




Nuk respektuan rregullat e qarkullimit rrugor, 42 të arrestuar për një javë në Tiranë, pezullohen 194 patenta (VIDEO)
11 Prill, 16:05

Kronikë




E reja në gjendje të dehur bën aksident, polici shkon në vendngjarje, ajo e rreh! Arrestohet 35-vjeçarja
11 Prill, 15:44

Kronikë



Qëlloi në drejtim të pronarit të shkollës private në Tiranë, zbardhet dëshmia autorit: Kam ngatërruar person! Armën e kisha fshehur te Liqeni
11 Prill, 13:38

Kronikë



Skemë kontrabande me shitjet online, prokuroria e Tiranës lëshon 22 urdhër arreste! Evazion fiskal miliona euro! 16 administratorë në pranga, operacioni në vijim

 Arsen Rusta
11 Prill, 11:20

Kronikë



Qëlloi pronarin e shkollës private në Tiranë te Liqeni i Thatë gjatë kohës që po udhëtonte me makinë, kapet pas tre muajsh autori
10 Prill, 17:45

Kronikë



U vra 5 vite më parë, shpallet qytetar nderi në Kamzë ish-komisari Artan Cuku
10 Prill, 12:40

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje